



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

### V E N D I M K.P.P. 611/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-24492-05-29-2019, me objekt: “*Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja” – “Disha” – “Sadik Petrela”*”, me fond limit 206,644,117.48 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k.  
*Adresa: Lagjia “Zall Mner i Ri”, Rruga Nacionale, Kamëz.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë  
*Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. BOE ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së BOE ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-24492-05-29-2019, me objekt: “*Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja” – “Disha” – “Sadik Petrela”, me fond limit 206,644,117.48 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*

II.2. Në datën 08.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 25.07.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Elda-VI” shpk	0.00 lekë, skualifikuar;
2. “Alba Konstruksion” shpk	140,149,702.34 lekë, skualifikuar;
3. “Arfiaj” shpk	147,073,517.00 lekë, skualifikuar;
4. “Almo Konstruksion” & “Ulëza Ndërtim” shpk	148,855,683.00 lekë, skualifikuar;
5. “Eprofat-V50” shpk	149,597,179.00 lekë, skualifikuar;
6. “Company Riviera 2008” shpk	158,598,170.00 lekë, kualifikuar;
7. “Kthella” shpk	159,272,530.00 lekë, kualifikuar;
8. “Glavenica” & “Shendelli” shpk	165,267,257.00 lekë, kualifikuar;
9. “4 AM” shpk	170,693,738.34 lekë, kualifikuar;
10. “BE-IS” shpk	172,842,612.00 lekë, skualifikuar;
11. “Biba X” & “Pe-Vla-Ku” shpk	174,752,414.00 lekë, skualifikuar;
12. “Pepa Group” & “Junik” shpk	179,510,557.18 lekë, kualifikuar;
13. “Sireta 2F” & “EuroAlb” shpk	180,962,499.00 lekë, kualifikuar;
14. “Iliriada” shpk	186,278,370.33 lekë, skualifikuar;
15. “Dabar” shpk	188,175,787.34 lekë, skualifikuar;
16. “Ed Konstruksion” shpk	201,689,186.00 lekë, skualifikuar

III.4. Në datën 25.07.2019, BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyen si më poshtë vijon:

*“Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk nuk përmbush pikën 7 të Kapacitetit teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi (Kategoria IV)”, pasi kanë deklaruar 4 punonjës si teknik ndërtimi përkatësisht me iniciale: N.D, Z.N, A.B dhe H.ZH. Për punonjësit me iniciale N.D, H.ZH dhe A.B dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik i përket kategorisë II, çka bie në kundërshtim me kategorinë e kërkuar që është IV. Për punonjësën me iniciale Z.N nuk është paraqitur dëshmia e kualifikimit e sigurimit teknik.*

*• Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk nuk ka paraqitur në Shtojcën 10 mjetet si më poshtë vijon: Kokore minimumi 80 (tetëdhjetë) copë, Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 (katër) copë; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë; Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë.”*

III.5. Në datën 30.07.2019, BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit duke argumentuar si më poshtë vijon:

*[...]Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk nuk përmbush pikën 7 të Kapacitetit teknik, Kriteret e veçanta të Kualifikimit, DST Ju sqarojme se:*

*Mbështetur në ligjin Nr.8734 date 01.02.2001 “Per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ne ligjin Nr.13/2013, date 14.02.2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr.8737 date 01.02.2001” si dhe bazuar ne rregulloren e sigurimit*

teknik per impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike, eshte e percaktuar qarte qe Tekniket e Ndertimit nuk mund te marrin kategorine IV pasi kjo kategori jepet vetem per: Personeli elektronik mjeshtra elektromontjer, personeli i ndërresës në centrale, nënstacione dhe i rrjetit elektrik.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik te Agjensise se Prokurimit Publik nje deklarate nga shoqeria “TCPE” Sh.p.k. si kompani e akredituar per certifikimin e punonjesve dhe rregulloren per sigurimin dhe shfrytezimin teknik per impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike, ku shprehet qartesisht se tekniket e ndertimit nuk futen te grupi i sigurimit teknik ne grupi e IV.

Per me teper, ne rregulloren e Sigurimit teknik Elektrik, percaktohet se: “GRUPI I KATËRT I SIGURIMIT TEKNIK. Në Grupin e katërt të sigurimit teknik elektrik ju u përket: Personelit në central nënstacione dhe rrjete elektrike, elektroteknik, mjeshër elektromontier. Mosha JO më pak se 20 vjeç, Eksperienca në punë JO më pak se 2 vjet në grupin e III të sigurimit teknik, ndërsa për personat që kanë mbaruar shkollë specialiteti jo më pak se 1 vit në grupin e III. Inxhinierët dhe tekniket e rinj duhet të kenë një stazh në punë në impiantet dhe linjat elektrike mbi tre muaj. Duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në impiantet elektrike. Gjithshtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë në përcaktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik, si dhe të dijë të ushtrorë kontroll mbi punonjësit gjatë punimeve.

Pra, skualifikimi si me sipër krijon kushte për pamundësi objektive të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriter, pasi kategoria IV e sigurimit teknik, jepet vetëm për individë që janë në profesione me drejtim edukimi profesional elektrik (pasi vetëm ata mund të kualifikohen në këto shkallë profesionalizmi në fushën përkatëse).

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk nuk ka paraqitur në Shtojcën 10 mjetet si më poshtë vijon: Kokore minimumi 80 (tetëdhjetë) copë, Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 (katër) copë; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë; Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë, ju sqarojme se:

Ne dokumentat standarte të tenderin mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punotoreve janë jashtë shtojcës numer 10. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas DST që verteton pronesinë e tyre. Duke qenë se këto mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punotoreve nuk janë të përfshira në shtojcën numer 10 edhe bashkimi i operatorëve nuk i ka futur në tabelën e shtojcës. Për më tepër, ky është një detaj minimalist i cili nuk ndikon aspak në krijimin e bindjes për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet, pasi BOE ka paraqitur të gjithë dokumentacionin përkatës për këto pajisje teknike. Referuar edhe formatit që përmban shtojcën 10, dikton vetëm detajimin e mjeteve që kanë të dhëna specifike identifikimi, si targe, shasi, leje qarkullimi, etj. Pra referuar strukturës së kësaj shtojce, struktura e cila është e miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, përfshirja në shtojcë e këtyre pajisjeve nuk është një domosdoshmëri. Ajo çfarë duhet të jetë e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që Operatorët ekonomikë të kenë paraqitur si pjesë të dokumentave të tenderit këto pajisje. Mbeshtetur sa përshtruar me lart vendimi i skualifikimit të Bashkimit të

*operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk & “Ulëza Ndërtim” shpk nuk është i drejtë dhe në kundërshtim dhe interpretim të gabuar të legjislacionit të prokurimit publik.[...]*”

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, rezulton se me anë të shkresës nr.29840/2 prot., datë 05.08.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k. lidhur me ankesën, duke e refuzuar atë.

II.7. Në datën 14.08.2019, BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8. Në datën 27.08.2019, me anë të shkresës nr.31769/1prot., datë 26.08.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar..

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të BOE ankimues, në zbatim të nenit 30 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, në të cilin parashikohet se “*Komisioni shqyrton, ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktues gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, referuar ankesës të paraqitur nga ankimuesi për veprimet e paligjshme të autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentat e procedurës prokurimit objekt shqyrtimi, nga informacioni i autoritetit kontraktor për shkaqet e skualifikimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këto kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe konkretisht vëren se:

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi, konstatohet se në shtojcën 12, pika 2.3.7 *“Për kapacitetin teknik”*, autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin si më poshtë vijon:

*“7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

- 4 (katër) punonjës hidraulik (Kategoria II)
- 3 (tre) punonjës elektrikist (Kategoria II)
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues (Kategoria I)
- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi (Kategoria IV)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmite e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.4. Në nenin 27, pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar parashikohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, jo diskriminuese, si dhe të mbështetura në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor, ndër të tjera ka kërkuar disponimin e 2 (dy) punonjësve teknik ndërtimi, të cilët duhet të jenë të pajisur me dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik kategoria IV. Bazuar në legjislacionin sektorial në fuqi, si dhe në mënyrë specifike në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, ku për grupin/kategorinë IV përcaktohet se pajisen: *“Teknikët dhe inxhinierëve të rinj, personeli*

*në central nënstacione dhe rrjete elektrike, elektroteknik, mjeshër elektromontier*”, Komisioni konstaton se dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk mund të lëshohet për teknikët e ndërtimit, sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Komisioni gjykon se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik e atë sektorial, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit.

III.1.6.Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteri i mëspërm për kualifikim, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe atë sektorial, pasi hartimi i kriterit në këtë mënyrë krijon konfuzion si tek operatorët ekonomikë ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave për vlerësimin e tyre, si edhe nuk krijon një panoramë të qartë të autoritetit kontraktor mbi kapacitetet e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, detyrim ligjor që rrjedh nga zbatimi i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata konfuze e krijuar nga përcaktimi i kriterit të paligjshëm për kualifikim, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi.

Në nenin 31 pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktues për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi një kriter haptazi të paligjshëm, mbi të cilin ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e BOE ankimues nuk do të merren në shqyrtim në themel pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet, kjo në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-24492-05-29-2019, me objekt: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja” – “Disha” – “Sadik Petrela”, me fond limit 206,644,117.48 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen saj të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktues, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Almo Konstruksion” sh.p.k. & “Ulëza Ndërtim” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1400 Protokoli Datë 14.08.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**